

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Reforma e re territoriale/ Rama përplaset me banorët e Poliçanit dhe kryebashkiakun socialist Adriatik Z otka: Qepeni gojën
ADRESA	https://dosja.al/live-updates/reforma-e-re-territoriale-rama-perplaset-me-banoret-e-poli-canit-dhe-i513940
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:01:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 15:59:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5d189d762daeeb0a19ff74152cbcad4315de570be883c93f890c7ab444d6fe01
TEKSTI	57f79c5793737c2898ce86e2ba32810eb7b624b287bfbde27bc6294df2a0a1b0
PAMJA	ccd1e0924d69ba232e8ec56c72b85c4290c5fd76f715f4f97b1e16558a7ad6a0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	925077ae5b092eec24608d477e2e52730e979d0f97749db04ad2d6376d956988
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	189cdded276785f170fe9cc7ce5e87625aab0e70d3bc68c5e8e7b4173c15ebbc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/925077ae5b092eec24608d477e2e52730e979d0f97749db04ad2d6376d956988

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES ▾

2 ORE ME PARE

Dita e 106-të e protestës/ Qytetarët zbrisin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

3 ORE ME PARE

Reforma e re territoriale/ Rama përplaslet me banorët e Poliçanit dhe kryebashkiakun socialist Adriatik Zotkaj: Qepeni gojën

8 ORE ME PARE

Të shtëna me armë zjarri në Mat/ Gjendet e djegur makina e autorëve, shënjestra ishte Akil Lleshi, makina e të birit u qëllua me 35 plumba

9 ORE ME PARE

"Vetë zot, vetë shkop"/ Ngërçi me pagat e gjyqtarëve, shpërthen Rama: Do nxirrni dhembët për të shumëfishuar rrogat! KLP e KLGJ, shëmbëlltyra e errët e reformës në drejtësi

LIVE UPDATES

Reforma e re territoriale/ Rama përplaslet me banorët e Poliçanit dhe kryebashkiakun socialist Adriatik Zotkaj: Qepeni gojën

• Reforma e re territoriale e propozuar nga PS-ja e cila synon shkrirjen e disa bashkive dhe bashkimin e tyre me disa të tjera vijon të sjell debate. • Takimi i kryeministrit Edi Rama në Berat ditën e sotme, u kthye në një arenë përplasjesh dhe debatesh me kryebashkiakun e Poliçanit, Adriatik Zotkaj, si dhe aktoren Eglë Ceno. • Takimi u zhvillua në ambientet e Hotel Colombo, ku diskutimi për Reformën Territoriale nisi me fjalën e Ministrit të Pushtetit Vendor, Ervin Demo. • Pas përfundimit të fjalës së ministrit Demo, përfaqësuesit e Poliçanit morën fjalën për të shprehur pakënaqësitë e tyre. • Por situata u tensionua duke sjellë përplasje verbale mes kryeministrit Rama, kryebashkiakut të Poliçanit, Adriatik Zotkaj, dhe aktore Eglë Ceno. • Debat i është përshkallëzuar gjatë diskutimeve, ndërsa Rama, në një moment, u është drejtuar banorëve me fjalët: "Qepeni gojën". • Pas kësaj ngjarje, aktorja Eglë Ceno dha versionin e saj. • Gjatë një prononcimi për mediat, Ceno u shpreh se në sallë ishte një grup përfaqësuesish nga Poliçani për të bërë një dëgjese për Territoriale, duke theksuar se Poliçani është një qytet që e ka shprehur shumë herë mendimin e tij. • Aktorja u shpreh se Ministri Demo u dha fjalën qytetarëve, ku folën vetëm 2 prej tyre, por pastaj ndërhyri kryeministri duke iu thënë se kjo nuk është një mbledhje për të dëgjuar sa mirë jetohej në Poliçan. • Ceno tha se i ka drejtuar kryeministrit Rama një pyetje ku i kërkonte të dëgjonte qytetarët, por pas kësaj ai e ka nxjerrë jashtë. Kjo duke thënë se mbledhja do të ndërpritet derisa Ceno të dalë nga sallja ku po mbahej mbledhja.

3 artikuj për këtë temë.

3 ORE ME PARE

Takimet për Reformën Territoriale/ Rama në Berat: Çfarë lidhje ka distanca?, ndryshon vetëm drejtimi vendor



Edi Rama

TIRANA- Kryeministri i vendit, Edi Rama ka zhvilluar ditën e sotme një takim në Berat për të diskutuar me banorët në lidhje me reformën e re territoriale. Pas takimit i cilu u shoqërua me tensione, përmes një postimi në rrjetin social Facebook

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 13 SHTATOR 2026, 12:07

Analiza: Si po përdoret IA-ja
për sigurinë në shkollat e
Shqipërisë

AKTUALITET 13 SHTATOR 2026, 09:45

Detaje nga të shtënat me armë në Mat/ Reth 30 gëzhoja gjenden në vendngjarje, pronarët e mjetit të djegur sapo ishin kthye nga Italia

BOTA 13 SHTATOR 2026, 09:34

Kremlini sjell në front reliktet e një princi të shekullit të 14-të

Më tej, lideri i qeverisë shtoi se Poliqani dhe Dimali do të kenë drejtuesin e tyre dhe do të kenë këshilltarët e tyre në Këshillin Bashkiak të bashkisë Berat, me kuota. Rama theksoi se ndryshimi kryesor lidhet me mënyrën e drejtimit vendor, pasi Poliqani dhe Dimali nuk do të kenë më kryetarë bashkie të zgjedhur më vete.

Kryeministri Rama: Më thoni çfarë mendoni ju se do të dëmtohet në rast se do të bëhet bashki. Kur më thua rruga, e më thua shërbimi, këto nuk ndryshojnë. Nuk do të ikin shërbimet nga Poliqani, nga Dimali ose nga askund. Përkundrazi, këto nuk ndryshojnë. Në raport me çfarë keni, ndryshon vetëm një gjë; nuk do të keni kryetar bashkie të zgjedhur.

Nuk ndryshon godina, nuk ndryshon stafi, nuk ndryshon numri i shërbimeve që bëhen, në kuptimin nuk ulet, se duhet shtuar. Ti thua distanca? Ça lidhje ka distanca? Ato shërbime që ti merr sot në Poliqan ose në Dimal, do t'i marrësh po aty. Pra, bashki, qytet, njësi administrative. Dhe qyteti Poliqan, qyteti Dimal do të kenë drejtuesin e tyre, do të kenë këshilltarët e tyre në Këshillin Bashkiak të bashkisë Berat, me kuota.

Më thoni dhe një gjë tjetër, komunat janë më mirë sot apo ishin më mirë kur ishin veç, se këto biseda unë i kam dëgjuar “mot a mot” në kohën e reformës 2015; “do na ikë ajo, do na ikë kjo, jo distanca; ohu, sa larg është Poliqani, ne jemi këtu te komuna jonë; sa larg është qendra e Urës, ne jemi te komuna jonë; ne kemi këtë, kemi atë, kemi kryetarin e komunës...

Ndodhi ndonjë gjë e kësaj natyre? A janë sot, a kanë marrë më shumë investime komunat se ç'bënin më përpara apo kanë marrë më pak? Investimet e komunave nga iu erdhën? Nga vetja? Iu erdhën nga bashkimi./Dosja.al

3 ORE ME PARE

“Dil jashtë”/ Egla Ceno rrëfen përplasjen me kryeministrin Rama në Berat: Nuk pati provokime nga ana jonë, unë vetëm i kërkoja të na dëgjonte (VIDEO)



më të klikuarat

“Qepeni gojën”/ Debate për shkrirjen e bashkisë, Rama përplaslet me banorët e Poliqanit dhe kryebashkiakun socialist Adriatik Zotkaj! Qytetarët largohen nga takimi

Nga “Taken” te Thethi/ TikTokeri, me 4 milionë ndjekës, që i tregoi botës një Shqipëri tjetër

Të shtëna me armë zjarri në drejtim të një automjeti, gjendet e djegur edhe një makinë

Detaje nga të shtënat me armë në Mat/ Reth 30 gëzhoja gjenden në vendngjarje, pronarët e mjetit të djegur sapo ishin kthye nga Italia

insights

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari


Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka

Pse Erion Veliaj e “shkarkoi” sot Edi Ramen?

Fjola Graçi

REPUBLIKA E



Egle Ceno

BERAT- Reforma e re territoriale e propozuar nga PS-ja e cila synon shkrirjen e disa bashkive dhe bashkimit të tyre me disa të tjera vijon të sjell debate. Takimi i kryeministrit Edi Rama në Berat, u kthye në një arenë përplasjesh dhe debatesh me kryebashkiakun e Poliçanit, Adriatik Zotkaj, si dhe aktoren Egle Ceno.

Pas kësaj ngjarje, aktoria Egle Ceno ka rrëfyer edhe versionin e saj. Gjatë një prononcimi për mediat, Ceno u shpreh se në sallë ishte një grup përfaqësuesish nga Poliçani për të bërë një dëgjese për Territorialen. Ajo theksoi se Poliçani është një qytet që e ka shprehur shumë herë mendimin e tij.

Aktorja u shpreh se Ministri Demo u dha fjalën qytetarëve, ku folën vetëm 2 prej tyre, por pastaj ndërhyri kryeministri duke iu thënë se kjo nuk është një mbledhje për të dëgjuar sa mirë jetohej në Poliçan.

Më tej ajo shtoi se kishte edhe djem nga salla që ngrinin dorën për të replikuar, po asnjë nuk u lejua të flasë. Ceno tha se i ka drejtuar kryeministrit Rama një pyetje ku i kërkonte të dëgjonte qytetarët, por pas kësaj ai e ka nxjerrë jashtë. Kjo duke thënë se mbledhja do të ndërpritet derisa Ceno të dalë nga salla ku po mbahej mbledhja.


Egle Ceno: Ishim një grup përfaqësuesish nga Poliçani për të bërë një dëgjese për Territorialen. Poliçani është një qytet që e ka shprehur shumë herë mendimin e tij. Ministri Demo u dha fjalën qytetarëve, folën vetëm 2 prej tyre. Pastaj ndërhyri kryeministri dhe tha: "Ok, ok, se nuk jemi në një mbledhje për të dëgjuar sa mirë jetohej në Poliçan", dhe fillon një fjalim që kishte pyetje, kishte përgjigje vetë, kishte djem nga salla që ngrinin dorën për të replikuar, po asnjë nuk u lejua të flasë.

Kur ishte drejt fundit thashë: "A mund të flasim, a do na dëgjoni?". Më tha: "Dil jashtë". "Po mo", i thashë, "dal edhe jashtë", por më thanë që kemi ardhur sepse kryeministri do na dëgjojë zërin. "Dil jashtë", të lutem, i thashë. "Jo, mos m'u drejto kështu."

U çua shumë i irrituar dhe tha: "Ndërpritet mbledhja derisa të dali zonja jashtë." Në ato momente, i gjithë komuniteti u bë bashkë me mua dhe dolëm të gjithë jashtë. Nuk pati as provokime nga ana jonë. Unë vetëm i kërkoja të na dëgjonte dhe të flisnim./Dosja.al

6 ORE ME PARE

"Qepeni gojën"/ Debate për shkrirjen e bashkisë, Rama përplasjet me banorët e Poliçanit dhe kryebashkiakun socialist Adriatik Zotkaj! Qytetarët largohen nga takimi



PROKURORE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvernec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zinj"

Moti

Powered by tomorrow



Adriatik Zotkaj, Egla Ceno, Edi Rama

BERAT- Kryeministri Edi Rama është përfshirë në debate të ashpra me qytetarët e Poliçanit gjatë takimit të zhvilluar në qytetin e Beratit për Reformën Territoriale. Mësohet se pjesë e takimit ka qënë edhe aktorja Egla Ceno.


Takimi u zhvillua në ambientet e Hotel Colombo, ku diskutimi për Reformën Territoriale nisi me fjalën e Ministrit të Pushtetit Vendor, Ervin Demo. Pas përfundimit të fjalës së ministrit Demo, përfaqësuesit e Poliçanit morën fjalën për të shprehur pakënaqësitë e tyre.

Më tej situata u tensionua duke sjellë përplasje verbale mes kryeministrit Rama, kryebashkiakut të Poliçanit, Adriatik Zotkaj, dhe aktores Egla Ceno. Debatë është përshkallëzuar gjatë diskutimeve, ndërsa Rama, në një moment, u është drejtuar banorëve me fjalët: “Qepeni gojën”.

Pas debateve përfaqësuesit e ardhur nga Poliçani vendosën të bojkotojnë takimin, dhe u larguan nga ambientet ku po zhvillohej mbledhja./**Dosja.al**

Sondazh

Poll



Përplasjet e Ramës me banorët e Poliçanit, qytetari: U soll si sulltan, u tha qepeni gojën

[Shiko video te tjera](#)



KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetare e rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë

AKTUALITET
POLITIKE

Drejtör: Enton Abilekaj
Kryeredaktor: Izmir Akulli

zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të
qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të
interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email:



[KONTAKT](#) [PRIVACY POLICY](#) [COOKIES](#)

MBINDHËSIAR TIGA Mediadesk

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Gazetarë:

Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.